DALAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-1344/1
Data Datum Date 30.011.2018

# Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Venera Çerkini, u.d i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL | Date: 26/11 /2018<br>Nr. 020-1844 |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës se Gllogocit | |
| Lloji i aktit: | ☐ Vendim | |

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim Nr. 400-69511/18 për dhënien e drunjëve të konfiskuar institucioneve arsimore në komunën e Gllogocit |
| I miratuar më datë: 23.11.2018 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 23.11.2018 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi***. Sa i takon shpërndarjes se druve duhet të ketë ***"vendim të gjykatës kompetente"***.

_Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-1344/1
Data Datum Date 30.11.2018

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Ramiz Lladrovci, gradonačelnik Opštine Glogovac<br>Labinot Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac | |
| Cc: | Jednici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jednici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Ivan Todosijević, ministar MALS-a<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a | |
| Od: | Venera Çerkini, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština- MALS | Datum, 26.11.2018 |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine | Br. 020-1844 |
| Vrsta akta: | ☐ Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obaveznu rapsravu zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-40 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 400-69511/18 za davanje oduzetog drveta obrazovnim ustanovama u opštini Glogovac |
| Usvojena dana, 23.11.2018. godine, |
| Predložena za razmetranje u MALS-u dana, 23.11.2018. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni efekat. Što se tiče podele (distribucije) drveta treba da ima ***"odluka nadležnog suda".***

Ministartsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

ZYRA E SHKRESAVE – HYRJE / INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 23.11.2018
-VII- 020-1844

**Republika e Kosovës**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr.060-69527 dt. 22.11.2018**

Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labinot Halilaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen urgjente të mbajtur më dt : 22/11/2018

1. Vendim për dhënien e drunjeve të konfiskuara, për institucionet arsimore në Komunën e Drenasit

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosova**
**Komuna Drenasit**
**Municipality Drenas**
**Zyra Kryetarit**
**Nr.01-400-69584 dt.22. 11 /2018**

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen urgjente të mbajtur më dt : 22/11/2018

1. Vendim për dhënien e drunjeve të konfiskuara, për institucionet arsimore në Komunën e Drenasit

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**Komuna e Drenasit**
Kuvendi i Komunës

12 Nr 400-69511 dt. 22/11/ 2018

Duke u bazuar në neni 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën I të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Vendimit të MASHT-it, Nr.1998, të datës 08.05.2018, si dhe kërkesës Nr. 04-060-69330, të datës 21.11.2018, të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, si dhe nenit 34pika 34.6, dhe propozimin vendimin e Kryetarit të Komunës nr 400-69397 të datës 21.11.2018. Kuvendi i Komunës në mbledhjen urgjente, të mbajtur me datë 22.11.2018 aprovoi këtë:

# VENDIM

## Për dhënien e drunjëve të konfiskuar për institucionet arsimore në Komunën e Drenasit

### Neni I

I lejohet Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, dhënia e drunjëve të konfiskuar për Institucionet Arsimore në Komunën e Drenasit.

### Neni II

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, do të lejoj dhënien e drunjëve të konfiskuar për institucionet arsimore, në vlerë të përafërt prej 1792 euro, apo 89.60 mhp.
Drunjte e konfiskuar qe i jepen për institucionin e paraparë ne këtë nenë të kenë procedurë të përfunduar gjyqësore.

### Neni III

Obligohet Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, që pas marrjes së vendimit nga ana e kuvendit të komunës së Drenasit, të lejoj bartjen e këtyre drunjëve të konfiskuar neper institucionet Arsimore.

Neni IV

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

21. 11 18
01 . 060 . 69380

# REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik

**PËR**: Ramiz Lladrovci-Kryetar

**NGA**: Anita Avdullahu-Dvorani Drejtor i DBZHE-së

**Lënda**: Kërkesë

Duke u bazuar në kërkesën e Drejtoris se Arsimit si dhe gjendjes Emegjente që është krijuar nga vendimi i Ministrisë së Mjedisit për ndalimin e përdorimit të thëngjillit si lënd djegëse.

Pas marrjes së kërkesës, kam kontaktuar Agjensionin Pyjor në Prishtinë të cilët verbalisht më kan njoftuar që mundeni me vendim të kuvendit tu ipen shkollave në shfrytëzim për shkak të gjendjës Emergjente që kemi. Me propozim dhënja e drunjëve të konfiskuara për Institucionet Arsimore.

Andaj kërkoj nga Ju i nderuar Kryetar, që të thirrni nje mbledhje Emergjente të Kuvendit.

Falemderit për mirëkuptim!

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KOMUNA DRENAS**
**DREJTORATI PER ARSIM**
**Dt. 21.11.2018, Nr.** 09- 400- 69289

PËR: Anita Avdullahu- Drejtoresh në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim Ekonomik

NGA: Tafil Halilaj- Drejtor i Drejtoratit për Arsim në Drenas

LËNDA: Kërkesë

E nderuara znj.Drejtoresh, duke e marrë parsyesh vendimin e MASHT-së për mos përdorimin e thengjillit si lëndë djekse nëper shkolla, kemi ardhur në një pozitë të veshtirë për përbushjen e nevojave për lëndë djekse nëpër Institucionet arsimore, si dhe vonesat në procedurat e tenderimit.
Drejtoria për Arsim duke e marrë parasyesh nevojen emergjente në furnizimin e shkollave më lëndë djekse në shkolla, kërkoj nga DBZHE që të na dalin në ndihmë më furnizim me drut e grumbulluar, konfiskuara nga rojet e pyellit, të cilat gjinden para objektit të Komunës së vjetër.

Mbesim më shpresë që kjo kërkesë të shqyrtohet pozitivishtë!

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Drenas,më: 21.11.2018.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i Tehnologija--Ministry of Education Science andTechnology*

Kabienti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 018/333
Datë: 08/05/2018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010, nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

## VENDIM

1. Për ndërprerjen e përdorimit të thëngjillit (si lëndë djegëse) për ngrohje, në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara si dhe nevojën për mbrojtjen e ambientit dhe fëmijëve në shkolla, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**
1. Kabinetit të Ministrit/ MASHT;
2. Zyrës së SP/MASHT;
3. DKA-ve;
4. Arkivit.

Shyqiri Bytyqi
Minister/MASHT